

ZËRI I POPULLIT NË VEPRIM



NDIKIMI I POPULLIT NË DEMOKRACI

LORAND (13), RINOR (13), VALON (13), FLORIAN (13), GENTA (12), DIORITA (12), ARDIANA (13)

QAZIM (12)




Nga ne do të mësoni se pse demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes

Demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes sepse në të populli ka fuqinë më të madhe për të vendosur për të ardhmen e tij. Demokracia është shfaqur për herë të parë në vitin 507 në Athinë të Greqisë. Në atë kohë, nuk kishte demokraci të plotë sepse nuk kishte të drejta të barabarta për të gjithë. Për shembull, të drejtë vote kanë pasur vetëm burrat dhe të pasurit, kurse të varfërit dhe gratë nuk e kanë pasur këtë të drejtë.

Sot, demokracia është zhvilluar shumë më shumë sepse të gjithë kanë të drejta të barabarta dhe të gjithë kanë të drejtë për të votuar mbi moshën 18 vjeçare.

Por, pasi që gjithmonë ka hapësirë për ndryshime ne jemi ata që mund t'i sjellim këto ndryshime. Nëse të gjithë i zbatojmë parimet e demokracisë si: tolerancën, drejtësinë, solidaritetin, lirinë, barazinë, paqen dhe sovranitetin vendi ynë do të funksionojë shumë më mirë. Ne e kemi fatin që jetojmë në një shtet të pavarur dhe demokratik, prandaj do të mundohemi t'i zbatojmë gjithmonë parimet e demokracisë.

Kosova shteti ynë, ka demokraci përfaqësuese parlamentare, ku çdo qytetar i moshës 18 vjeçare del të votojë dhe i zgjedh përfaqësuesit e vendit të tij. Përfaqësuesit e popullit janë deputetët dhe detyra e tyre është që ta përfaqësojnë popullin në mënyrën më të mirë të mundshme.



Të gjithë i kemi të drejtat e barabarta

Qytetarë të nderuar, nëse dëshironi të keni një të ardhme më të mirë ju lutemi t'i respektoni parimet e demokracisë, sepse vetëm kështu mund ta ndërtojmë një të ardhme të ndritshme. Ju e dini se ndryshimi fillon nga vet ne, prandaj ne jemi ata që duhet të punojmë për të mirën e vendit tonë. Vetëm në këtë mënyrë të gjithë mund të jetojmë të lumtur dhe të lirë. Pra, ti vendos për të ardhmen dhe jetën tënde.




Votuesit e së ardhmes

NE JEMI E ARDHMJA

LEONITA (12), ARLIND (12), ALTIN (12), LULZIME (12), ERONA (13), BAJRAM (12), PRANVERA (12)

Në artikullin tonë mëso më shumë për demokracinë, zgjedhjet dhe votën. Mëso pse janë zgjedhjet një proces i rëndësishëm dhe sa shpesh ndodhin ato në shtetin tonë


Ndryshimi fillon nga ti. E ti ndryshimin e bën me anë të votës tënde. Zgjedhjet janë „materia përbërëse“ e demokracisë. Pse? Sepse ne me anë të procesit të votimit, zgjedhim udhëheqësit tanë. Ndonëse zgjedhim gjatë tërë kohës, vendimi që e marrim në procesin e zgjedhjeve është zgjedhja më e rëndësishme që ne bëjmë. Kosova ka dy lloje të zgjedhjeve. Në zgjedhjet komunale (Lokale) ne zgjedhim kryetarin e komunës. Ndërsa në zgjedhjet qendrore (parlamentare) zgjedhim deputetët e Kuvendit të Kosovës. Një votë e jona vlen shumë, prandaj kur ne të arrijmë moshën 18 vjeçare dhe të kemi të drejtë të marrim pjesë në procesin zgjedhor, do të votojmë gjithmonë. Ne në klasën tonë kemi zgjedhur kryetaren e klasës, andaj ne që nga tash jemi të vetëdijshëm se vota duhet të jetë e pavarur dhe nuk duhet të imponohet nga askush.



Ne të gjithë kemi të drejtën e votës



Në „Demos-ti“ mësuam se zgjedhjet ndodhin çdo 4 vite



Vota jonë e vendos të ardhmen



Duhet të votojmë personin që e meriton votën tonë



Deputetët duhet të punojnë për mirëqenien tonë



Autorët e artikullit

KUVENDI, VENDI MË DEMOKRATIK

ANESA (13), SHKURTA (12), ERZINA (12), ADMIR (12), RINOR (13), PAJAZIT (13), ALBION (12),
MENDIM (12)


Në këtë artikull keni mundësinë të lexoni më shumë për një vend demokratik dhe për institucionin e rëndësishëm, pra Kuvendin

Kosova është shtet sovran. Populli i Kosovës ka të drejtën e lirisë, shkollimit, punësimit, të drejtën e fjalës, të votës etj. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, të cilët e udhëheqin popullin.

Kosova ka ligje të shumëllojshme, të cilat qytetarët duhet t'i zbatojnë, dhe ato ligje mund t'i propozoj Qeveria dhe deputetët, por në disa raste Presidenti si dhe populli. Kuvendi ka 3 funksione kryesore: funksionin legjislativ, kontrollues dhe përfaqësues. Pra, Kuvendi e përfaqëson popullin, mbikëqyr Qeverinë dhe miraton ose nuk miraton ligjet. Vendi më demokratik i popullit është Kuvendi që ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“. Ne jemi e ardhmja, prandaj duhet të punojmë për të mirën e këtij vendi.



Gazetarët e këtij artikulli




Voto për një të ardhme të mirë



Bashkëpunimi, mënyra më e mirë e komunikimit



Deputetët, përfaqësuesit e popullit



Pushteti legjislativ, Kuvendi

QYTETARËT AKTIV TË KOSOVËS

ARMEND (12), ALBANI (12), ERZA (13), SHKURTA (13), SHPRESA (13), GËZIME (13), ERONI (12)



Ne, gazetarët e këtij artikulli mendojmë se qytetaria aktive është e rëndësishme për shtetin tonë, prandaj kemi vendosur të tregojmë si mundemi të gjithë të bëhemi qytetarë aktiv

Ne mendojmë se qytetarë janë të gjithë njerëzit të cilët jetojnë në Kosovë apo në vende të tjera. Të gjithë qytetarët duhet të jenë të regjistruar në regjistrin civil. Ndërsa, qytetarët aktiv janë qytetarët të cilët ndihmojnë shtetin duke punuar shumë dhe duke ndihmuar qytetarët e tjerë. Këtë ndihmë ne e japim pa dallime feje, gjinie, race etj. Kjo do të thotë se ne i ndihmojmë edhe qytetarët të cilët janë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë si komuniteti serb, turk, boshnjak, goran, romë, ashkali, egjiptian. Por, si të jemi qytetarë aktiv? Ne jemi qytetarë aktiv kudo, duke filluar që nga shtëpia jonë. Shtëpia, është vendi ku ne jetojmë bashkë me familjen dhe të gjithë të afërmit. Në shtëpi ne mbrojmë familjen, komunikojmë me ata që kanë nevojë për

mbështetje, dëgjojmë kur flasin të tjerët, respektojmë familjarët dhe bëjmë çdo gjë që është e mundur për ta. Në lagjen tonë, ne kemi respekt edhe sillemi me edukatë ndaj personave me të cilët jetojmë. Ne dhe fqinjët tanë shpeshherë mblidhemi për ta pastruar lagjen tonë dhe për ta mbrojtur atë nga mbeturinat dhe tymrat. Ndërsa, shkolla për ne është vendi ku mësojmë, edukohemi edhe dëgjojmë mësuesen, arsimtarët dhe shokët e shoqet. Qytetin tonë, Prishtinën e mbajmë të pastër, sepse kështu mbrojmë shëndetin tonë dhe shëndetin e të tjerëve. Të gjitha këto veprime i bëjmë edhe për shtetin tonë. Ne kur të arrijmë moshën 18 vjeçare mund të votojmë për deputetët e Kuvendit të Kosovës, sepse për ne vota është shumë e rëndësishme. Në fund, qytetarët aktiv duhet t'iu ndihmojnë të gjithë qytetarëve të botës, ashtu siç ata na kanë ndihmuar neve. Sepse ne jetojmë të gjithë në të njëjtin planet, dhe jemi një familje e madhe.



Grupi ynë



Ne jemi qytetarë aktiv edhe në shtëpi



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hitmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-5
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë